



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:286907

Datë: 07.10.2024

Numri i dokumentit: 06258527

C.nr.802/2019

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI – Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Leotrim Gashi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Kompania e Sigurimeve “Elsig”, me seli në P., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit V. B., kundër të paditurit A.G., me vendbanim në fshatin S., të Komunës së V., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson R.B., avokat me seli në V., me objekt kontesti rimbursim i dëmit, me vlerë të objektit të kontestit 4,234.00 euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 24.09.2024, me datë 07.10.2024 mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Kompania e Sigurimeve “Elsig” dhe DETYROHET i padituri A.G., që në emër të rimbursimit të dëmit, të shkaktuar në aksidentin e datës 26.01.2012, t’ia paguaj paditëses shumën prej 4,234.00 euro me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data 09.12.2019 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 40.00 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësja me datë 09.12.2019, ka ushtruar padi në këtë gjykatë kundër të paditurit A.G., me objekt kontesti rimbursim i dëmit.

Pretendimet e palëve

Paditësja përmes padisë dhe gjatë seancave ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia e saj në tërësi si e bazuar dhe gjykata ta detyroj të paditurin që si përgjegjës i aksidentit të datës 26.01.2012, ta rimbursoj paditësen për kompensimin që paditësja i ka bërë të dëmtuarit nga ky aksident R. H.. Ka shtuar se pas aksidentit për faktin se i padituri e ka shkaktuar aksidentin pa pasur patent shofer, dhe për këtë arsye duke u bazuar në nenin 14 të Ligjit nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (LSDA), përgjegjësia për dëmin bie mbi të paditurin që ka vozitur pa patent shofer mjetin motorik të siguarur të paditësja, dhe për këtë shkak mjeti motorik e ka humbur edhe mbulesën siguruese. Në fjalën përfundimtare, përfaqësuesi i paditëses ka theksuar se gjykata duhet ta aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditëses sepse pas administrimit të provave është vërtetuar në tërësi baza dhe lartësia e kërkesëpadisë dhe për këtë arsye i padituri duhet t'ia rimbursoj paditëses shumën prej 4,234.00 euro.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë në shumën prej 40.00 euro për taksën e padisë.

I padituri përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar me përgjigje në padi ka theksuar se e konteston në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si për nga baza, ashtu edhe për nga lartësia lidhur me aksidentin e datës 26.01.2012, me arsyetimin se nuk ka prova me të cilat vërtetohet fajësia e të paditurit për shkaktimin e këtij aksidenti. Në seancën përgatitore të datës 10.09.2024, përfaqësuesi i të paditurit ka deklaruar se në shkresat e lëndës nuk ka ndonjë aktgjykim penal me të cilin do të vërtetohej pafajësia e tij e po ashtu ka theksuar se i padituri e ka drejtuar automjetin me të cilin është shkaktuar aksidenti i datës 26.01.2012 por që automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti ka qenë i siguarur te paditësja, kjo duke u bazuar në policen e sigurimit që dëshmon se automjeti ka pasur sigurim nga data 05.04.2011-05.04.2012 por paditësja me qellim t'i shmanget kësaj baze siguruese e ka kërkuar rimbursimin nga i padituri, duke shtuar se dyshojnë se po të ishte ndonjë kompani tjetër e sigurimit, nuk do ta kishte kërkuar nga i padituri rimbursimin. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se kërkojnë nga gjykata që ta refuzoj në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, sepse duke u bazuar në përgjigjen e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, nuk është vërtetuar përgjegjësia e të paditurit, duke shtuar se edhe pse i padituri është shkaktuar i aksidentit, ai ka poseduar regjistrim të automjetit i cili ka qenë edhe i siguarur.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Provat

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka administruar këto prova: Raporti i aksidentit 2011 – BD – 0084 i datës 26.01.2012, Vlerësimi mbi dëmin material i datës 13.08.2018, Procesverbal i shqyrtimit kryesor, në lëndën C.nr.564/2012, i Gjykatës Themelore Prishtinë, Urdhërpagesa e datës 14.09.2018, Ekspertiza mjekësore për lëndën C.nr.564/2012 i datës 03.07.2018, Ekspertiza e komunikacionit për lëndën C.nr. 564/2012 e datës 20.09.2016 dhe e-maili i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë i datës 23.09.2024, nga U.D udhëheqës i sektorit të shkrimores Sh. Sh. për gjykatën.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë dhe kërkesëpadisë, provave të propozuara si dhe përgjigjes në padi në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka çmuar me kujdes dhe me ndërgjegje çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë andaj e aprovoi në tërësi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Në mes palëve nuk ishte kontestues fakti se me datë 26.01.2012, ishte shkaktuar aksidenti i komunikacionit ku ishte përfshirë automjeti Opel Corsa, pronë e B. G. me targa të regjistrimit 02.709-AH, të cilin e ka drejtuar i padituri, kurse si i dëmtuar, ishte këmbësori R. H.. Nuk ishte kontestuese po ashtu se i dëmtuari R. H., kishte pësuar lëndime trupore në këtë aksident.

Kontestuese në mes palëve ishte fakti nëse i padituri ishte përgjegjës për shkaktimin e aksidentit dhe nëse e paditura ka të drejtë të kërkoj rimbursim nga ana e të paditurit.

Nga Raporti policor i aksidentit të trafikut me numër 2011 – BD – 0084 i datës 26.01.2012, së bashku me skicën, është konstatuar se në Rrugën “I. Q.”, shoferi i automjetit A (i padituri) i cili ka qenë duke drejtuar automjetin e pronarit B. G., e ka goditur këmbësorin (R. H.), që në bazë të raportit të mjekut ka lëndime të lehta trupore.

Nga Vlerësimi mbi dëmin material i datës 13.08.2018 i paditëses, lidhur me kërkesën për kompensim së të dëmtuarit është vërtetuar se e paditësja ka vlerësuar se të dëmtuarit duhet t'i takoj kompensimi material dhe jo material në shumën prej 3,300 euro.

Nga Procesverbal i shqyrtimit kryesor, në lëndën C.nr.564/2012, i Gjykatës Themelore Prishtinë, është vërtetuar se i dëmtuari R. H. në cilësi të paditësit dhe Kompania e Sigurimeve “Elsig” në cilësi të së paditurës kanë arritur pajtim gjyqësor ashtu që Kompania e Sigurimeve “Elsig” është detyruar që të dëmtuarit R. H., në emër të aksidentit të datës 26.01.2012, t’ia kompensoj shumën e përgjithshme prej 4,230 euro (3,300 euro kompensim dhe 934 euro për shpenzime të procedurës).

Nga Urdhërpagesa e datës 14.09.2018 është vërtetuar se paditësja në bazë të marrëveshjes së datës 14.09.2018, ka urdhëruar që të dëmtuarit R. H. t’i bëhet pagesa në shumën prej 4,234 euro, kurse nga Dëftesa e Bankës Teb e datës 29.09.2018, është vërtetuar se është kryer ky transaksion nga paditësja te avokati i të dëmtuarit B. S.

Nga Ekspertiza mjekësore për lëndën C.nr.564/2012, e datës 03.07.2018 dhe e punuar nga Dr. M. H. -ortoped dhe Dr. N. I.-M.- psikiatër, që është bazuar në raportet mjekësore të të dëmtuarit dhe ekzaminimin e drejtpërdrejtë të tij, është konstatuar se nga pasojat e aksidentit të datës 26.01.2012, i dëmtuari R. H. ka pasur lëndime të rënda trupore.

Nga Ekspertiza e komunikacionit për lëndën C.nr. 564/2012 e datës 20.09.2016, e punuar nga eksperti B. L., është konstatuar se deri te aksidenti i datës 26.01.2012 ka ardhur për shkak të lëshimeve të ngasësit të automjetit A e tipit “Opel Corsa”, me targa të regjistrimit 02-709-AH (të paditurit), për shkak të veprimeve të tij kthim djathtas i pasigurt në udhëkryq dhe moskujdes ndaj këmbësorit në udhëkryq. Për më tepër në këtë ekspertizë (Faqe 3) është përmbajtur edhe deklarata e të paditurit në Polici, e datës 26.01.2012, sipas së cilës ndër të tjera i padituri ka theksuar se *“Isha duke vozitur me veturën time Opel Corsa, ngjyrë hiri, me targa të regjistrimit 02-709-AH në Rr. “D. e K.” te Raiffaisen Bank dhe jam kthyer në të djathtë që të kyçem në Rrugën “I. Q.”, ku papritur një person i moshuar nga ana e djathtë ma ka prerë rrugën ka dashur të dal në anën e majtë të rrugës dhe në atë moment e kam goditur me anën e përparme të veturës, gjegjësisht me branikun nën dritën e partë të djathtë...”*. Po ashtu eksperti i komunikacionit në ekspertizë ka theksuar se shoferi i automjetit (i padituri) në momentin e shkakimit të aksidentit nuk ka poseduar patent shofer, me ç’rast te i njëjti mungon dëshmia e nevojshme për njohjen dhe respektimin e rregullave të përgjithshme të komunikacionit rrugor (Faqe 5).

Nga e-maili i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë i datës 23.09.2024, nga U.D udhëheqës i sektorit të shkrimores S. Sh., i dërguar nga Prokuroria pas kërkesës së kësaj gjykate për të siguruar informacionet e ndjekjes penale rreth aksidentit të datës 26.01.2012, është konstatuar se ky rast me urdhër të ish-kryeprokurorit të kësaj prokurorie është mbyllur nga prokurorët në stacione policore për shkak se ka arritur parashkrimin absolut.

Me nenin 136,1 të Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve (LMD) është përcaktuar që *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*, me nenin 137 të këtij ligji është paraparë që *“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”*, kurse me nenin 960 të po këtij ligji thuhet se *“Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguresin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të siguruarit kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin”*

Kurse me nenin 960 par 1, të LMD-së, parashihet që *“Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguresin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të siguruarit kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin”*

Po ashtu me nenin 14 par 1.2, i Ligjit 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia parashihet që *“1. I siguruari e humbë mbulesën siguruese kur: 1.2. drejtuesi nuk ka leje të vlefshme dhe adekuate për drejtim të mjetit motorik, përveç rasteve të përdorimit të mjetit motorik gjatë mësimave të drejtimit të mjetit nga kandidati, sipas të gjitha rregullave të përcaktuara për procesin e mësimi”*, kurse me par 3, të këtij neni thuhet se *“Siguruesi pas përmbushjes së detyrimit nga ky nen dhe paragrafi 3. i nenit 9 të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguruese”*.

Se i padituri është përgjegjës për shkaktimin e aksidentit të datës 21.01.2012, në të cilin ka mbetur i dëmtuar këmbësori R. H., gjykata e ka vërtetuar nga Raporti i aksidentit i Policisë së Kosovës me nr. 2011 – BD – 0084 i datës 26.01.2012, së bashku edhe me skicën e vendit të ngjarjes, e kjo e vërtetuar edhe nga ekspertiza e komunikacionit e nxjerrë për lëndën C.nr. 564/2012 e datës 20.09.2016, e punuar nga eksperti B. L., e cila ekspertizë bazuar në shkresat-provat e lëndës së këtij aksidenti ka arritur në konstatimin se aksidenti ka ndodhur për shkak të lëshimeve të të paditurit i cili ka bërë kthim të pasigurt djathtas në udhëkryq dhe nuk është

kujdesur ndaj këmbësorit-të dëmtuarit. Për më tepër lidhur me përgjegjësinë e të paditurit me këtë ekspertizë është theksuar se pasi i padituri në momentin e aksidentit nuk ka pasur patent shofer, i njëjti nuk ka pasur as njohuri për rregullat e përgjithshme të komunikacionit e po ashtu edhe fakti se i padituri e ka pranuar në deklarinimin e tij para organeve të ndjekjes ditën e ngjarjes se e ka goditur të dëmtuarin.

Prandaj për gjykatën këto prova të lartcekura janë të mjaftueshme për të vërtetuar se përgjegjës për aksidentin, në të cilin ka pasur lëndime trupore i dëmtuari R. H., ka qenë tani i padituri dhe ketë aksident e ka shkaktuar duke mos poseduar patent shofer.

Vlen të theksohet se pavarësisht se përfaqësuesi i të paditurit e ka kontestuar kërkesëpadinë, ai në seancën përgatitore të datës 10.09.2024, ka deklaruar se i padituri e ka shkaktuar aksidentin por këtë aksident e ka shkaktuar me një automjet që veçse ka qenë i siguruar¹ e po ashtu ky fakt nga përfaqësuesi i të paditurit është theksuar edhe në fjalën përfundimtare të datës 24.09.2024.²

Tutje, në këtë çështje për vërtetimin e përgjegjësisë së të paditurit në shkaktimin e këtij aksidenti gjykata është bazuar mjaftueshëm në ekspertizën e komunikacionit e nxjerrë për lëndën C.nr. 564/2012 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, e datës 20.09.2016, e punuar nga eksperti B. L., e cila është nxjerrë në kontestin në mes tani paditëses në cilësi të së paditurës dhe të dëmtuarit R. H. në cilësi të paditësit sepse kjo ekspertizë është profesionale, e cila është punuar duke un bazuar në të gjitha shkresat e lëndës dhe ka përshkruar në detaje lëshimet e të paditurit në shkaktimin e aksidentit të datës 26.01.2012. Kurse duhet thënë se edhe përfaqësuesi i të paditurit nuk është pajtuar që në këtë çështje të nxirret ekspertizë e re e komunikacionit me arsyetimin se nuk ka nevojë që të shkaktohen shpenzime të panevojshme dhe zvarritje të procedurës³, i cili propozim për ekspertizë të re fillimisht ishte propozuar nga paditësja, mirëpo më pas paditësja kishte hequr dorë nga ky propozim.

Në anën tjetër, pretendimi i përfaqësuesit të të paditurit se pasi Prokuroria Themelore në Mitrovicë, e ka njoftuar me e-mail gjykatën se kjo çështje është mbyllur për shkak të parashkrimit, vërtetohet se i padituri nuk ka përgjegjësi për aksidentin është tërësisht i pa bazuar sepse fakti se në procedurën penale çështja ka përmbyllur për shkak të parashkrimit të ndjekjes

¹ Procesverbali i seancës përgatitore e datës 10.09.2024. Faqe 3.

² Procesverbali i seancës kryesore e datës 24.09.2024. Faqe 4.

³ Procesverbali i seancës përgatitore e datës 10.09.2024. Faqe 5.

penale, nuk nënkupton se i padituri nuk është përgjegjës për aksidentin e datës 26.01.2024, fakt ky i vërtetuar nga provat e lartcekura.

Për gjykatën po ashtu është tërësisht i pabazuar edhe pretendimi tjetër i përfaqësuesit të të paditurit se pasi i padituri aksidentin e ka shkaktuar me veturën e cila ka qenë i siguar te paditësja, nuk është e nevojshme që të paguaj rimbursim, kjo ngase sipas nenit 14 par 1.2, i Ligjit 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia ku parashihet që “1. I siguruari e humbë mbulesën siguruese kur: 1.2. drejtuesi nuk ka leje të vlefshme dhe adekuate për drejtim të mjetit motorik, përveç rasteve të përdorimit të mjetit motorik gjatë mësimeve të drejtimit të mjetit nga kandidati, sipas të gjitha rregullave të përcaktuara për procesin e mësimit”, përcaktohet se humbet mbulesa siguruese nëse drejtuesi i automjetit të siguar nuk ka leje të vlefshme për drejtim të atij mjeti motorik, çka edhe ka ndodhur në këtë rast sepse pasi i padituri e ka vozitur automjetin i cili ka qenë i siguar te paditësja pa patent shofer, përgjegjësinë për këtë e bartë pikërisht i padituri sepse i siguruari (pronari i veturës) e ka humbur mbulesën siguruese. Konkretisht për dëmin që e ka shkaktuar vetura e siguar te paditësja, dëmin për të nuk e paguan paditësja si sigurues, por këtë duhet ta bëjë personi që e ka shkaktuar dëmin duke mos poseduar patent shofer për vozitjen e atij automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti.

Prandaj, pasi sipas nenit 9 të LSDA-së, paditësja si siguruese e mjetit me të cilin është shkaktuar aksidentin, me transferin bankar në bankën Teb, të datës 14.09.2018 e ka komepsuar të dëmtuarin në shumën prej 4,234 euro dhe duke u bazuar në nenin 14 par 3, të tij ku thuhet se “*Siguruesi pas përmbushjes së detyrimit nga ky nen dhe paragrafi 3. i nenit 9 të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguruese*”, dhe pasi në këtë procedurë gjyqësore është vërtetuar se i padituri është përgjegjës për këtë aksident të shkaktuar, gjykata në dispozitivin e këtij aktgjykimi, duke u bazuar edhe në nenin 960 par 1 të LMD-së, të paditurin e ka detyruar që shumën të cilën paditësja e ka kompensuar të dëmtuarin (4,234.00 euro) t’ia rimbursoj paditëses.

Gjykata përveç kërkesës kryesore, duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 par.2 të LMD-së dhe Mendimin juridik për kamatën i Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 265/2020 i datës 02.12.2020 paditëses i’a njohu edhe të drejtën në kamatë ligjore, në lartësi prej 8% në vit, duke llogaritur nga data 09.12.2018, si dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 452 të LPK-së sipas ku përcaktohet që *“Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtarë gjyqësore, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore”* dhe atë në shumën prej 40.00 euro, në emër të pagesës së taksës gjyqësore për padinë e parashtruar.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2019:286907, C.nr.802/2019, me datë 07.10.2024

G j y q t a r i

Leotrim Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.